VENDIM
Nr. 163, datë 22.10.2020

MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË OST SHA PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 1, të nenit 19, germa "c", pika "i", nenit 21 dhe nenit 55, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017 dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "c", dhe pika 3 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 109/11 prot., datë 15.10.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021,

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 5686 prot., datë 24.9.2020 (protokolluar në ERE me nr. 1118 prot., datë 25.9.2020), ka paraqitur aplikimin për miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021.

- Për sa i përket llogaritjes së tarifës mesatare të transmetimit për vitin 2021, shoqëria OST sh.a. ka paraqitur, sipas tabelës, llogaritjet përkatëse dhe ka kërkuar një shtesë prej 0.056 lekë/KWh nga tarifa e miratuar për vitin 2020, duke e çuar tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021 në vlerën 1.31 lekë/KWh nga 0.75 lekë/KWh që është aktualisht.

Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE", rezulton se OST-ja për qëllime të këtij aplikimi ka paraqitur pjesërisht si vijon:

- Në pikën 1 dhe 2, të nenit 21, parashikohet, ndër të tjera, se i licencuari duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas rregullores dhe metodologjive përkatëse; plotësuar pjesërisht.

- Në pikën 1, të nenit 22, përcaktohet se aplikimi shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- 1.1 Një deklaratë që përshkruan qëllimin dhe efektin e propozimit te paraqitur;

- 1.2 Efektet e pritshme në të ardhurat e shoqërisë nga tarifat apo çmimet e propozuara;

- 1.4 (d) Tarifat/çmimet e aplikuara nga aplikuesi ndaj klientëve të tij për çdo shërbim të energjisë elektrike dhe/apo te gazit natyror, duke përfshirë çdo informacion tjetër të nevojshëm për të argumentuar ndryshimet në tarifat/çmimet e kërkuara nga aplikuesi.

- OST-ja nuk ka dhënë shpjegime, në lidhje me ndryshimet e propozuara në tarifën e transmetimit, i cili është shërbimi i vetëm që ofron ky operator.

- OST sh.a. ka paraqitur vetëm një informacion të përgjithshëm rreth aktivitetit të saj, duke listuar përgjegjësitë kryesore të saj, të cilat burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe ato rregullatore në fuqi, duke cilësuar dhe kostot që tarifa e transmetimit synon të shlyejë.

- Rritja e propozuar sipas OST sh.a., e cila është paraqitur pa informacione dhe dokumentacion, por vetëm në formë narrative, është vlerësuar si rrjedhojë e pagesave të kredive që Shoqëria pret të ketë, investimeve të pritshme, të cilat pret të mbulojë me fondet e veta, si dhe rritjes së shpenzimeve që OST-ja pret të ketë për vitin 2021, lidhur me shërbimet ndihmëse me hyrjen në fuqi të "Rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike", sipas vendimit nr. 106, datë 2.7.2020, të Bordit të ERE-s, të propozuara nga vetë OST sh.a.

- Në pikën 2, të nenit 22, përcaktohet se, propozimet për përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve duhet të përmbajnë: një deklaratë të vitit të testimit, një raport vjetor për vitin e testimit,

shpenzimet, të ardhurat dhe tarifat/çmimet e aplikuara gjatë vitit të testimit, si dhe rregullimet e propozuara që lidhen me shpenzimet, të ardhurat dhe tarifat/çmimet për vitin e testimit.

- Konstatohet se OST sh.a. nuk ka paraqitur një raporti mbi shpenzimet, të ardhurat dhe tarifat e aplikuara dhe realizuara, si dhe efektet e tyre në pritshmërinë për vitin 2020, ku nga sa rezulton në aplikim është viti 2019, i cili tashmë është i mbyllur dhe OST sh.a. disponon të dhënat mbi realizimin e çdo treguesi financiar, teknik dhe ekonomik. Ndërkohë, në aplikim janë paraqitur të dhënat për vitin 2019 dhe 2020 të miksuara, duke mos bërë të qartë efektet e realizimit të secilit komponent të përllogaritjes së tarifës gjatë vitit 2019, krahasuar me miratimin e tyre nga ERE, po për të njëjtën periudhë, efektet e realizimit të tarifës për vitin 2019, të cilat duhet të axhustohen në realizimin e treguesve financiarë për vitin 2020, si dhe realizimin e këtyre komponentëve për periudhën janar–shtator, të shoqëruar me pritshmërinë e shoqërisë deri në përfundim të vitit 2020.

- Në pikën 3, të nenit 22, përcaktohet se propozimet për përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve duhet të përmbajnë, ku është e aplikueshme, një përshkrim të çdo ndryshimi që lidhet me përbërjen e tarifave dhe çmimeve, duke përfshirë arsyet për këto ndryshime, efektet e ndryshimeve të propozuara ndaj klasave/grupeve të ndryshme të klientëve, ndaj shërbimeve të tjera që sigurohen nga aplikuesi apo shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë, si dhe ndryshimet në faturat përkatëse çdo klasë/grup të klientëve.

- Shoqëria nuk ka paraqitur asnjë informacion lidhur me efektet e tarifës së propozuar kundrejt tarifës aktuale dhe impakti i saj në veprimtarinë e shoqërive të tjera që ushtrojnë aktivitet në sektorin e energjisë elektrike.

- OST sh.a. nuk ka dokumentuar parashikimet lidhur me kërkesën për energji për vitin 2021 të shoqërive KESH sh.a., OSSH sh.a., FSHU sh.a. apo dhe FTL sh.a., si dhe sasive që parashikojnë të livrojnë në rrjetin e transmetimit, për vitin 2021 konsumatorët e mëdhenj të lidhur në Rrjetin e Transmetimit apo dhe të shpërndarjes.

- Në pikën 4, të nenit 22, përcaktohet se në qoftë se aplikuesi pretendon se ndonjë nga informacionet e kërkuara sipas këtij neni apo metodologjive përkatëse, nuk është i mundshëm, ai duhet të paraqesë arsyet e pretendimit. Paaftësia për të dhënë arsye të përshtatshme për mos paraqitjen e ndonjë informacioni shkakton trajtimin e propozimit si një propozim të parregullt.

- OST sh.a. në aplikim nuk ka shprehur asnjë deklarim e aq më tepër asnjë arsyetim të tillë.

Në zbatim të përcaktimeve të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike", rezulton se OST-ja, për qëllime të këtij aplikimi, ka paraqitur pjesërisht si vijon:

- në pikën 3, të nenit 5, përcaktohet, ndër të tjera, se pagesat e lidhjes me sistemin e transmetimit për përdoruesit e sistemit të transmetimit nuk janë objekt i kësaj metodologjie;

- nga aplikimi nuk rezulton të ketë një ndarje mes të ardhurave të realizuara dhe të pritshme, të pagesave të lidhjes me sistemin e transmetimit me të ardhurat e kërkuara;

- në pikën 7 dhe në pikën 8, të nenit 5, përcaktohet mes të tjerave se: kohëzgjatja e ciklit të shqyrtimit të tarifave të transmetimit është tre vjet;

- konstatohet se shoqëria vijon të aplikojë për tarifë, për një periudhë njëvjeçare, ndryshe nga sa parashikuar më sipër;

- në pikën 10, të nenit 5, përcaktohet se financimi afatgjatë i borxhit duhet përdorur për të financuar shpenzimet e reja kapitale për aq sa është e mundur, por nuk duhet përdorur për të mbuluar kostot e operimit;

- mungesa e një informacioni të detajuar në aplikim mbi kreditë e marra nga OST sh.a., nuk lejon vlerësimin dhe analizimin lidhur me destinacionin e përdorimit të këtyre fondeve;

- në pikën 11 dhe pikën 14, të nenit 5, përcaktohet se: i) aplikimi krahas informacionit dhe dokumentacionit argumentues të nevojshëm për llogaritjen e tarifës mesatare tavan të shërbimeve të rregulluara të transmetimit duhet të përmbajë dhe një informacion të plotë mbi treguesit teknikë,

ekonomikë dhe financiarë, si dhe llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjithë shoqërinë; dhe ii) kostot e përfshira në tarifë duhet të jenë transparente për palët e interesuara;

- rezulton se në aplikim janë paraqitur vetëm deklarime në formë narrative të pashoqëruara me informacione dhe dokumentacion të nevojshëm, siç janë kërkuar edhe më lart, çka nuk përmbush kushtet sa më sipër;

- në pikën 15, të nenit 5, përcaktohet se tarifa duhet t'i lejojë OST-së mundësinë e një kthimi të arsyeshëm mbi bazën e rregulluar të aseteve;

- rezulton se, OST-ja nuk ka paraqitur komponentët e llogaritjes së kthimit të lejuar mbi (RAB);

- në pikën 18, të nenit 5, përcaktohet, ndër të tjera, se në përgatitjen e aplikimit për tarifa OST-ja do të përpiqet të paraqesë gjithë kostot me saktësi deri në 100,000 lekë;

- konstatohen vetëm deklarime dhe tabela me shifra sintetike, të cilat janë paraqitur të pashoqëruar me dokumente dhe analiza jo vetëm për realizimin e tyre dhe pritshmërinë për vitin 2020 apo planifikimin e shoqërisë për kryerjen e këtyre shpenzimeve për vitin 2021. Në mënyrë që të konstatohen kostot me saktësi, por dhe tregues të tjerë financiarë, lidhur me aktivitetin e OST sh.a., duhet të ishin përcjellë llogaritë e shoqërisë sipas "Sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018;

- në pikën 4, të nenit 6, përcaktohet, se energjia elektrike e konsumuar nga facilitetet e OST-së me tension të ulët ose mesatar dhe të livruar nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes, duhet përfshirë në shumën totale të energjisë së livruar në rrjetin e shpërndarjes;

- në aplikim nuk paraqiten të dhëna apo argumente nëse energjia elektrike e konsumuar nga facilitetet e OST-së në nivelet respektive të tensionit si më lart dhe nuk është përfshirë në humbjet totale të sistemit të transmetimit të parashikuara për vitin 2021.

- Në pikën 3, të nenit 7, përcaktohet se, OST-ja duhet të paraqesë justifikime për çdo rregullim/korrigjim të parashikuar të rezultateve të vitit të testimit. Rregullimet duhet të specifikohen në tabelat e paraqitura nga OST-ja në aplikimin për tarifë, si dhe dëshmi me shkrim, duke dhënë prova për arsyet dhe nivelin e çdo korrigjimi/rregullimi;

- Rezulton e papërmbushur kjo kërkesë e metodologjisë. Në përmbledhjen tabelore, të paraqitur në këtë aplikim, të dhënat financiare, të realizuara për vitin 2019 dhe që priten të realizohen për vitin 2020, janë paraqitur të miksuara, duke mos reflektuar rregullimin/korrigjimin e realizimit të treguesve financiarë dhe asnjë informacion apo dokumentacion vërtetues (provë) për arsyet dhe nivelin e çdo korrigjimi/rregullimi;

- pika 4 (4.2.4), e nenit 7, përcakton se, amortizimi i kategorive të ndryshme të aseteve do të bazohet mbi jetën operuese të pritshme të këtyre aseteve. Nëse të dhënat financiare janë shtrembëruar nga përdorimi i shifrave shumë të larta për jetëgjatësinë e amortizimit, atëherë OST-ja paraqet një studim për amortizimin e asteve, i cili duhet të tregojë jetën e aseteve për çdo kategori;

- OST-ja nuk ka dhënë shpjegime për jetën operuese të aseteve për vitin 2019 dhe pritshmërinë për vitin 2020;

- në zbatim të pikës 5, nenit 60, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të paraqesë pranë ERE-s, së bashku me aplikimin për miratimin e tarifës edhe planin e përditësuar të investimeve për vitin pasardhës, detyrim, i cili nuk është përmbushur nga ana e OST sh.a.;

- në nenin 8 përcaktohet ndarja e kostove për kapacitet, energji dhe pagesa fikse mujore;

- rezulton se në këtë aplikim janë paraqitur disa tabela, të cilat evidentojnë llogaritjen e totalit të kapaciteteve të përdoruesve, por pa deklaruar se sa është kapaciteti i vënë në dispozicion dhe sa për qind zë nga ai i përdorur;

- në pikën 3, të nenit 19, të rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, parashikohet se: Bordi merr vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit nëse konstaton se aplikimi plotëson kryesisht kërkesat sipas rregulloreve përkatëse;

- rezulton se aplikimi i OST sh.a., përgjithësisht, nuk përmbush kërkesat dhe përcaktimet e: i) ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; ii) "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s"; iii) "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike"; iv) "Sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike";

- aplikimi i shoqërisë OST sh.a. nuk plotëson kriteret formale dhe të përmbajtjes, si dhe ka kryesisht mangësi në dhënien e shpjegimeve mbi aspekte të veçanta të këtij aplikimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021 prej 1.31 lekë/KWh.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti